



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:270969

Datë: 27.11.2024

Numri i dokumentit: 06516936

C-IV-14-4951

*Ankuesi*

R K, Prishtinë.

**Kundër:**

*E paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

**Për: Palët**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 26 nëntor 2024, lëshon këtë:

### AKTGJYKIM

- APROVOHET** ankesa si pjesërisht e bazuar dhe **NDRYSHOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së PRN093-0121 datë 03 qershor 2014.
- OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankuesit **R K** në emër të kompensimit për asistencën sociale për periudhën prej 01 janar 2005 – 14 gusht 2007, t’i paguaj **shumën prej 600.00 €**, ndërsa pjesa tjetër e kërkesës **prej 900.75 €**, përtej shumës së aprovuar refuzohet.
- Shuma e aprovuar si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushet në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.

### Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 26 qershor 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme një ankesë kundër Vendimit nr. PRN093-0121, të datës 03 qershor 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për kompensimin e mjeteve të asistencës sociale NSH “Gërmia” (në likuidim). Ankuesi theksoi se ka bërë ankesë kundër vendimit të AKP-së për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të dispozitave të ligjit mbi AKP. Ankuesi më tej thekson se nuk është vërtetuar fare gjendja faktike deri në momentin e likuidimit të NSH “Gërmia” duke pohuar se ai ka qenë në listën e pagave dhe ka marrë edhe 20% nga shitja e aseteve të Ndërmarrjes në likuidim. Ankuesi më tej shton se ka të drejtë në shfrytëzim të mjeteve të qirasë sepse ai është lajmëruar në punë por, pa fajin e tij ai është caktuar në asistencë sociale të cilit asistencë sociale i është dhënë nga të ardhurat që vijnë nga qiratë e paguara për

këto lokale. Ankuesi më tej thekson se NSH “Gërmia” nuk ka qenë duke funksionuar si Ndërmarrje prodhuese andaj, prona e kësaj ndërmarrje është dhënë me qira dhe prej qirave, ai ka marrë asistencën sociale dhe në momentin e likuidimit ai ka kërkuar asistencën sociale të papaguar në periudhë prej 01 janar 2005 deri me 14 gusht 2007, në shumë prej 1,500.75 € që i bie në kalkulim 50 € në muaj. Ankuesi thekson se aplikimi i gabuar i dispozitave të ligjit mbi AKP-në, në bazë të nenit 23 pika 1 dhe 1.1 të Ligjit mbi AKP, është se ai si punëtor - kreditor ka dorëzuar formularin me kërkesë që t’i paguhen mjetet - pagat të cilat janë grumbulluar prej qirave të objekteve të NSH “Gërmia” në Prishtinë. Ankuesi po ashtu shton se, si ish punëtor – kreditor i plotëson kushtet për njohjen e të drejtës për marrjen e asistencës sociale nga qiratë e grumbulluara nga Ndërmarrja NSH “Gërmia”. Ankuesi i propozon gjykatës që të obligoj AKP-në që të bjerë vendim që t’i paguaj mjetet – pagat e papaguara nga qiratë dhe që t’i paguaj edhe shpenzimet e procedurës. Nga shkaqet e theksuara ankuesi propozon që DHPGJS të bjerë vendim që të vendos në mënyrë meritore në këtë çështje. Ankuesi në mbështetje të ankesës së tij ka bashkangjitur dëshmitë në kopje si: vendimin e kundërshtuar, Formularin për parashtrimin e kërkesës jo - pronësore në likuidim, dorëzuar në Agjenci datë 19 shtator 2007, Njoftimin për Fillimin e Likuidimit të NSH “Gërmia”, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit (në tri gjuhë) datë 14 gusht 2007 lëshuar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) dhe Kërkesën për informata shtesë nr.3916 të datës 30 prill 2014 dërguar ankuesit.

Me 20 nëntor 2024, e paditura AKP-ja parashtrroi mbrojtjen e saj në të cilën pohoi se i përmbahet qëndrimit se AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. E paditura konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekt i kësaj procedure gjyqësore është **vetëm ligjshmëria (përputhshmëria me Ligjin 04/L-034) e vendimit të AL**. Në këtë kontekst, 74.2 i Ligjit 06/L-086 parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. E paditura thekson rregullin bazik të procedurës civile kontestimore sipas të cilit parashtruesi ka detyrimin dhe barrën e provës (Neni 7 i LPK dhe Neni 31 i Ligjit 06/L-086). Një rregull i tillë është shprehimisht i paraparë edhe në nenin 23.2.4 dhe 23.3 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034. E paditura thekson se ankesa është e refuzuar, pasi AL më 30 prill 2014 i ka dërguar parashtruesit një kërkesë duke i kërkuar të dorëzoj dokumentacion shtesë në mbështetje të kërkesës së tij, konkretisht, vendimin mbi asistencë sociale të lëshuar nga menaxhmenti i N.SH “Gërmia” për periudhën janar 2005 deri më gusht 2007. Parashtruesi i është përgjigjur kërkesës së dërguar nga AL me 13 maj 2014, por nuk ka paraqitur vendimin e kërkuar për asistencën sociale përgjatë periudhës së pretenduar. Andaj, AL në bazë të nenit 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në, AL ka arritur në përfundim që dëshmitë e kërkesës të dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës mbeten jo të plota edhe pas kërkesës për plotësim të dokumenteve. Neni 36.2.2 i Shtojcës së Ligjit për AKP-në, parashikon *“elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij Ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë... dokumentacioni për kërkesën apo interesin e pretenduar i paraqitur nga kreditori i pretenduar apo bartësi i interesit të pretenduar, mbetet jo i plotë edhe pas kërkesës nga kreditori i pretenduar për dokumente apo dëshmi plotësuese”*. Prandaj, AL refuzoi kërkesën si të pavlefshme. E paditura i propozon gjykatës që të refuzoj ankesën si të papranueshme dhe të pabazuar si dhe të vërtetoj vendimin e AL-së në pajtim me nenin 74.4 të Ligjit nr.06/L-086. E paditura në mbështetje të mbrojtjes së saj ka bashkangjitur dëshmitë në kopje si: Vendimin e

kundërshtuar, Formularin për parashtrimin e kërkesës në likuidim të datës 19 shtator 2007, Kërkesën për informata shtesë nr.3916 të datës 30 prill 2014 dërguar ankuesit, Njoftimin për Fillimin e Likuidimit të NSH “Gërmia”, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) datë 14 gusht 2007 (në tri gjuhë), Fletë kthesën e postës të datës 03 maj 2014 dhe Vendimin për përbërjen / emërimin e anëtarëve të AL nr. DM 530/2023 datë 4 gusht 2023.

Për detaje të tjera, referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parashih se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa, pika 3 parashih se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Nga pohimet e palëve dhe shkresat e lëndës gjykata gjen se ankuesi ka kundërshtuar vendimin e AL nr. PRN093-0121, datë 03 qershor 2014, me të cilin vendim, edhe pas kërkesës për dëshmi dhe informacione shtesë ishte refuzuar në mungesë të provave kërkesa e tij për kompensimin e mjeteve të asistencës sociale në shumë prej 1,500.75 € për periudhën kohore prej 1 janar 2005 – 14 gusht 2007 nga NSH “Gërmia” (*në likuidim*).

Ankuesi, bazën e kërkesës së tij ndër të tjera e mbështet në: Formularin për parashtrimin e kërkesës jo - pronësore në likuidim, dorëzuar në Agjenci datë 19 shtator 2007, Njoftimin për Fillimin e Likuidimit të NSH “Gërmia”, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit datë 14 gusht 2007 lëshuar nga AKM dhe Listën e punëtorëve në asistencë sociale I – XII 2005 – Analiza e asistencës sociale përfunduar me 31 dhjetor 2005; faqe 1-9, (Listë e cila nuk është dorëzuar në

këtë lëndë, por në disa lëndë të tjera të kësaj natyre që janë në shqyrtim në gjykatë si: C-IV-14-4965, C-IV-14-6120, C-IV-14-6448, etj.), si dhe në pohimet e parashtruara në ankesë.

Nga Lista e punëtorëve në asistencë sociale I – XII 2005 – Analiza e asistencës sociale përfunduar me 31 dhjetor 2005; faqe 1-9, vërtetohet fakti se ankuesi kishte statusin e punonjësit në asistencë sociale dhe se NSH-ja i kishte mbetur borxh ankuesit shumën bruto prej 600.00 € në emër të asistencës sociale për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2005 (nr. rendor 89). Andaj, gjykata e aprovon pjesërisht kërkesën e ankuesit pra shumën prej 600.00 €, duke u bazuar në të e veçanërisht duke ia falur besimin listës së punëtorëve në asistencë sociale I – XII 2005 – Analiza e asistencës sociale përfunduar me 31 dhjetor 2005, (një kopje e listës në fjalë, me këtë rast vendoset në dosje të kësaj lënde si dëshmi relevante) ndërsa pjesën tjetër të kërkesës në mungesë të dëshmive e refuzon.

Gjykata pasi ka shqyrtuar në tërësi të gjitha dëshmitë e dorëzuara në këtë rast në lidhje me kërkesën për kompensim të asistencës sociale për periudhën objekt kontesti, ka gjetur se pjesa tjetër e kërkesës përtej shumës së aprovuar, për periudhën 1 janar 2006 – 14 gusht 2007, nuk është e mbështetur në prova dhe dëshmi relevante. Siç ka arsyetuar edhe e paditura në mbrojtjen e saj, ankuesi kishte dështuar të dorëzonte prova dhe dëshmi relevante edhe në procedurën e likuidimit kur ishte shqyrtuar kërkesa e tij kreditore nga AL.

Andaj, gjykata vie në përfundim se meqenëse ankuesi kishte statusin e punonjësit në asistencë sociale tek NSH-ja dhe se ka pjesërisht dëshmi se NSH i kishte mbetur borxh kompensimin për periudhën e lartcekur, kështu i takon e drejta në kompensim të mjeteve të asistencës sociale, në shumën e aprovuar. Një interpretim i tillë është në pajtim edhe me precedentët e fundit të DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit në lidhje me këto raste dhe këtë NSH (AC-I-22-0320, AC-I-22-0465, etj.).

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjyqimit.

### **Taksat gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli  
Gjyqtar